



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 206 dt.20.10.1994

PER
BERJE PROPOZIMI PER DHENIE PENSIONI
TE POSACEM SHTETEROR

Këshilli i Bashkisë i Tiranës, në mbledhjen e kësaj date, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Seksioni i Organizimit që pasqyron kërkesën e Ministrisë së Mbrojtjes, firmosur nga ministri i saj Z. Safet Zhulali, për bërje propozimi Këshillit të Ministrave “Për dhënie pension të posaçëm shtetëror” familjeve të gjashtë ushtarakëve ish efektiv të regjimentit të helikopterëve në Tiranë të cilët vdiqën në krye të detyrës në vitin 1989

Vëren se :

Më dt.22.11.1989, dy helikopterë të regjimentit të Farkës, ku në përbërje të ekujpazheve ishin gjashtë ushtarakë të këtij regjimenti, marrin detyrën për tu ardhur në ndihmë një grupi studentësh të universitetit Bujqësor të Kamzës, të cilët duke u kthyer nga praktika, aksidentohen me autobuzin e tyre në zonën midis Himarës dhe Grykës së Llogarasë.

Helikopterët me ekujpazhet dhe me personelin e duhur mjeksor u gjendën në Himarë.

Me gjithë kushtet e vështira atmosferike, helikopterët me të plagosurit u nisën për Tiranë, por një rrymë shumë e fuqishme ajrore me stuhi, shi të madh i përplasi në faqen perëndimore të malit të çikës dhe si pasojë humbën jetën të dy ekujpazhet bashkë me personat e tjerë.

Për aktin heroik dhe shpirtin e sakrificës që treguan antarët e ekuipazheve që dhanë jetën në krye të detyrës për të shpëtuar të plagosurit, u dekoruan me urdhërin e shërbimit ushtarak të kl.I. Mbështetur në statusin e veçantë që gëzojnë ushtarakët dhe familjet e tyre në Republikën e Shqipërisë, si dhe në bazë të V.K.M Nr.152, dt.05.04.1994 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore”. Këshilli i Bashkisë së Tiranës

VENDOSI

1. Ti propozojë Këshillit të Ministrave që gjashtë familjeve të ushtarakëve Agron Esat Galanxhi, Vangjel Vangjel Postoli, Tafik Njazi Agaj, Veledin Deli Resuli, Enver Osman Haka dhe Pandeli Jorgo Xhupa, të cilët ranë në krye të detyrës, tu akordohet pension i posaçëm shtetëror seicilës prej 2.000 lekë në muaj.

KRYETARI

BESNIK PETRELA